



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Data __. __. 2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Punë

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Ndërtim i parkut të ri të qytetit".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Artikuj për parqe lojrash, lojra tavoline ose sallash-37530000-2; Pajisje për parqe lojrash -37535200-9; Stola në parqe -39113600-3; Pajisje për park dhe shesh lojërash-43325000-7;

VLERA E FONDIT LIMIT: 25 770 830 (njëzetë e pesë milion e shtatëqindë e shtatëdhjetë mijë e tetëqindë e tridhjetë) lekë pa tvsh.

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit ka marrë në dorëzim projekt-preventivin dhe dokumentacionin teknik përkatës të hartuar nga Shoqëria "Novatech Studio" sh.p.k i cili rezultoi se i është referuar nenit 76 të pikës (a) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar, që përcakton "çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj)", Shoqëria "Novatech Studio" sh.p.k për llogaritjen e çmimeve është mbështetur në manualin teknik të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizave teknike të tyre nr.625 datë 15.07.2015, (ndryshuar me VKM-në nr.631, datë 26.10.2018, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë e matshme dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

Arsyeja e përdorimit të procedurës së prokurimit : "E hapur" është sepse fondi limit është mbi kufirin e ulët monetar në sektorin klasik, bazuar në, ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" nenin 42 dhe 52 ; në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" nenin 11, pika 1, gërma b) dhe neni 47,74,77, si dhe në VKM nr. 291, datë 15.5.2024 "Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik", kreu II pika 2/a .

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik";", Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik", Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

Këto kriterë janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kriterë janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14, pika 2, dhe 77, pika 1/a dhe 2, të LPP i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per

prokurimin publik";nenin 39, pika 6/b, dhe nenin 88, Pika 4 të të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar.

Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet e përkatësisht: 25 000 000 lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenin 43,pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (b) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formes elektronike".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: 2021, 2022 dhe 2023, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në përputhje me ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c "c) (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një dokument që vërteton se ka paguar të gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore për të gjitha vendet ku operatori ushtron aktivitetet për vitin 2023 dhe për vitin 2024(këstet e maturuara).

- ❖ *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, në ligjin nr.9920 date 19.05.2008 "Per procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2 d). Referuar sa mësipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen eaktivitetit të tyre dhe për tju nënshuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme :

a) Punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pese viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës e përkatësisht: 12 000 000 lekë pa tvsh.

Ose

b) Punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pese viteve të fundit, të jetë jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet e përkatësisht: 51 000 000 lekë pa tvsh.

Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike, **Pika 2.3.1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse **pika 2.3.1/b** duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar
- Akt i kolaudimit
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontrate Sipërmarrje;
- Situacion/faturë tatimore;
- Akt i kolaudimit
- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9;

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e bashkimit të operatorëve të deklaruar në fazën e tenderimit.

Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin nga ana e Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021, parashikon se "Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika

a(1,2,3,4,) dhe b(1,2,3,4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit:

- **N.P-1 A Punime gërmimi në tokë.**
- **N.P-2 - Ndërtime civile dhe industriale**
- **N.P-7 A Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi dhe vaditje;**
- **N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisore**

Për punimet speciale të ndërtimit:

- **N.S-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të Ligjit Nr. 16/2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”i ndryshuar, si dhe Vendim nr.42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores, për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategorite dhe nivelet e licencave të kerkuara janë bazuar në Lidhjen 2,3 dhe 4 të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin E Rregullores Për Kriteret Dhe Procedurat E Dhënies Së Licencave Profesionale Të Zbatimit, Klasifikimit Dhe Disiplinimit Të Subjekteve Juridike, Që Ushtrjnë Veprimtari Ndërtimi

Konkretisht:

Llojet e licencave dhe klasifikimi i tyre, sipas kategorive dhe niveleve (gërmave) përkatëse janë bërë në përputhje me natyrën e punimeve respektive dhe vlerën e përlogaritur sipas preventivit të hartuar për këtë objekt.

KATEGORIA	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislativonit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kerkuar për katego
------------------	--	---	---

			rine respek tive
N.P. 1-A Punime gërmimi në tokë	Konsider ohen gërmimet, sistemime t dhe ndryshim et në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjete, pavarësis ht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohe t, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorris hte ose shkëmbor e.	Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kateg III, me shk ne mjet	Niveli A
		Gërmim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	
		Transport dheu me auto deri 5.0 km	
		Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	
		Transport dheu me auto deri 5.0 km	
		Sistemim, nivelim dhe pasurim dheu me humus 5kg/m2	
		Gërmim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kate me shk ne mjet	
		Transport dheu me auto deri 5.0 km	
		Gërmim dheu kanal kablo, shtyllat dhe pusetat + transp. mat. . 5 km	
		Transport dheu me auto deri 5.0 km	
		NP-2A Ndërtime civile dhe industrial e	Konsider ohen ndërtime, mirëmbaj tje ose ristrukturi me me ndërhyrje të sakta, në
F.V. Pllaka betoni 6cm veteshtrenguese			
N/shtr. bet. 10cm niv.e fiks.e bord C 7/10			
F V bordura betoni 15x35 cm			
Bordura betoni 6x20 cm per peme			
Ishuj shtrese rere t=15 cm			

objekte ku zhvillohen aktivitetet njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompleti me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësues dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudh	Struktura b/a c 16/20 per stola tip 3		
	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm		
	F V hekur betoni periodik > 10 mm		
	Shtrese zhavor lumi t=20cm		
	Shtrese pllaka terakote		
	Struktura monolite betoni C 16/20		
	Struktura b/a c 16/20 per stol rreth shatrivanit		
	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm		
	F V hekur betoni periodik > 10 mm		
	Listela per stolat		
	Struktura b/a c 16/20 per stol amfiteatri		
	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm		
	F V hekur betoni periodik > 10 mm		
	Listela per stolat		
	F.V.Rreshkitese per femije (kabine + shkalle + plan rreshkites)		
	F.V. Kolovajse per femije (bazament ulje + bazamet mbajtes)		
	F.V.kosha		
	Shtrese zhavori t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri		
	Shtrese betoni C-16/20 t=15 cm		
	F.V. hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm		
	Shtrese gome 1.2 cm + praimer		
	Shtrese taratan		
	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm		
	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²		
	Transport dheu me auto deri 5.0 km		
	Beton per themelin dhe xokol C-16/20		
Nenshtrese zhavori nen themel			
Rrethim I fushes me rrrjete metalike(H=2m)			
Rrethim I fushes me rrrjete plastike (H=3m)			
Koloncina metalike dhe porta			

	<p>ore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderr, betonim të tavaneve të hollë, membran a, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.</p>	<p>Lyerje konstruksione metalike</p>											
<p>NP-7.A Ujësjiellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje</p>	<p>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për</p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="521 1472 1325 1577">F.V. pompe 1.1kw Qmax=140l/min Hmax= 22m</td> <td data-bbox="1325 1472 1446 1577">Niveli A</td> </tr> <tr> <td data-bbox="521 1577 1325 1667">F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, t = 3.7 mm, PN 10</td> <td data-bbox="1325 1577 1446 1667">10</td> </tr> <tr> <td data-bbox="521 1667 1325 1766">F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, t = 3.0 mm, PN 10</td> <td data-bbox="1325 1667 1446 1766">10</td> </tr> <tr> <td data-bbox="521 1766 1325 1818">F V tuba plastmase per vaditje, Ø 25 mm</td> <td data-bbox="1325 1766 1446 1818"></td> </tr> <tr> <td data-bbox="521 1818 1325 1881">F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm</td> <td data-bbox="1325 1818 1446 1881"></td> </tr> </table>	F.V. pompe 1.1kw Qmax=140l/min Hmax= 22m	Niveli A	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, t = 3.7 mm, PN 10	10	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, t = 3.0 mm, PN 10	10	F V tuba plastmase per vaditje, Ø 25 mm		F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm		
F.V. pompe 1.1kw Qmax=140l/min Hmax= 22m	Niveli A												
F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, t = 3.7 mm, PN 10	10												
F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, t = 3.0 mm, PN 10	10												
F V tuba plastmase per vaditje, Ø 25 mm													
F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm													

<p>realizimin "e shërbimit hidrik kompleks " dhe veprave lidhëse, plotësues e ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësi</p>	F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm		
	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²		
	Nenshtrese zhavori		
	F V rezervuari zingato 5000 litra		
	sistemi I ujitjes se shatervanit		
	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, t = 4.7 mm, PN 10		
	F.V pompe 1.1kw Qmax=140l/min Hmax= 22m		
	Puse kontrolli 1.5x1.5x1,5m		
	F.V Saraçineske PPR 1/2"		
	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²		
	Nenshtrese zhavori		
	F V rezervuari zingato 5000 litra		
	Shpim pusi 20 m komplet +aksesore		

	<p>t, kullat e ujit, stacionet e pompimit , depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura</p>		
NP12-A	<p>Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndarës në</p>	Mbjellje sipërfaqe me bar	Niveli A
Punime të inxhinierisë mjedisore		F.V. Fidane Peme dekorative	

	territor, dhe vlerësim të kompaktë simit të zhvillimit të qëndrues hëm të ekosistem it,			
Kategoria NS-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike , radiotelef oni TV	Konsider ohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike , radiotelef oni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësues ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i	FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm	Niveli A	
		F V pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm		
		FV pusete BA 60x60x60, kapak gize		
		F.V. Kuader komandimi per ndricimin rrugor me fotoelemet		
		F.V.Kabell Cu me dy shtresa mbrojtese 5x6mm2		
		F.V.Kabell Cu me dy shtresa mbrojtese 5x4mm2		
		F.V.Kabell Cu me dy shtresa mbrojtese 5x2,5mm2		
		F.V.Kabell Cu me dy shtresa mbrojtese 3x2,5mm2		
		F.V.Percjelles Cu 16mm2 I veshur GV		
		F.V. Tub fleksibel me 2 shtresa D=63mm		
		F.V Beton C 12/15 per fiksimin e shtyllave		
		F.V. Tuba metalik D=110mm		
		F.V.Shtylle klasike ndricimi H=4,3m, me dy krahe 2x40W/LED		
Shirit tregues per trase kablli				

	<p>sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.</p>		
--	--	--	--

Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme (sipas Lidhjes 3)

- Kategoria NP-1 A (Punime germimi në tokë)

Konsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet, vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishte ose shkëmbore.

Referuar zerave të preventivit dhe sasise së punimeve të cilat përfshijnë gërmimet për themelet e godinës së re, gërmim për kanalizimet KUZ të shkollës, gërmime dhe sistemime të ndryshme të shesheve për ndërtimin e terreneve sportive, operatori ekonomik duhet të disponojë këtë kategori në nivelin A nga 0 deri në 20 milion lekë për këto punime.

Kategoria NP-2 -A Ndërtime civile dhe industriale Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejta ose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadione, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të parandëruar, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.

Kategoria N.P. 12-A Punime të inxhinierisë mjedisore Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të baseneve hidrografike, eliminimin e prishjes së ekuilibrave hidrogeologjike, nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karriera dhe mbetjeve inerte.

Kategoria NP-7. A Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje në rrjet që janë të nevojshme për realizimin "e shërbimit hidrik kompleks" dhe veprave lidhëse, plotësuese ose ndihmëse edhe në pika të veçanta, si edhe në të gjitha impiantet mekanike të nevojshme për të pasur një shërbim të mirë të nevojshëm gjatë përdorimit, funksionimit, informimit, sigurisë dhe asistencës për një funksionim

normal. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar veprat e kaptazhit të ujit, ujësjellësit, kullat e ujit, stacionet e pompimit, depozitat në tokë ose të ngritura, rrjetin shpërndarës deri tek përdoruesi, furnizimi dhe vendosja në vepër e tubacioneve, shkarkimet e ujërave të zeza, si dhe trajtimin e ujërave të përdorura.

Kategoria NS-14 A Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimit të ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.

2.3.3. a. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- Inxhinier Ndertimi - 1 (një)

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma
- CV
- Licence

Inxhinier Ndertimi, duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë **minimalisht për muajin e fundit**.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të paraqesë inxhinieret e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjesisin e kerkuar si me sipër, emer/mbiemer, numrin dhe datën e certifikatës, si dhe institucionin që ka leshuar këtë dokument.*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Së pari, kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c".

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është

*përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij **drejtues teknik** të cilët kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij.*

Kriteri për stafin teknik kryesor, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Staf i inxhinierëve, është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

b. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin mbështetës** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Elektrik
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi

Për secilin duhet të paraqiten:

- Kontratë punë e vlefshme
- Diploma
- CV

Inxhinierët e mesiperm të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për muajin e fundit kur është pjes e stafit të shoqërisë ndërsa kur është siguruar nga operatori ekonomik me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi nuk kërkohet të figuroj në listëpagesat përkatëse.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, **i ndryshuar**, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77, Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Nenit 39, pika 6/c) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin mbështetës lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

c. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar dhe të figurojnë në listëpagesat e subjektit, punonjësit specialistë të kualifikuar, si më poshtë:

EMERTIMI	
Teknik të mesëm ndërtimi	(2 persona)
Teknik të mesëm topograf	(1 person)
Elektricitist	(1 person)
Pllakashtrues	(4 persona)
Hidraulik	(2 persona)
Saldator	(1 person)
Karpiertier	(1 person)

Për punonjësit me profesionet si më sipër, në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të ketë mundësinë e verifikimit, Operatorët Ekonomikë duhet të plotësojnë dhe ngarkojnë tabelën e mëposhtme me të dhënat e sakta që i përkohet diplomes/certifikatës së formimit profesional nga Institucione Private apo Shtetërore, të cilat regjistrohen në bazën e të dhënave të AKPA-së pranë Ministrisë së Financave (Institucioni përgjegjës për formimin profesional).

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni	Nr amzes/regjstrit dhe data e lëshimit	Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Nr NIPT (Në rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
etj					

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë:

- Kontratën individuale të punës;
- Një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (certifikatë/dëshmi), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licencuara /akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, sipas ligjit nr. 15/2017 “Per arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë.”

**(Per tekniket e mesem duhet te paraqitet diploma ose deftesa e perfundimit te shkolles se mesme profesionale).*

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi : *Kërkesat e gërmes c) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021*

“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.” dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i mesëm i Ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivave të punimeve.
- **Tekniku i mesëm topograf** është i nevojshëm për matjet e nevojshme zbatimin e projektit .
Elektracisti është i nevojshëm për kryerjen e punimeve elektrike sipas zërave të preventivit të punimeve
Pllakashtruesit janë të nevojshëm për kryerjen e punimeve shtrimin të trotuareve për punimet në rrugë sipas zërave të preventivit të punimeve.

d. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të dëshmojnë se kanë të punësuar në stafin e shoqërisë punonjës të kualifikuar, të pajisur me Dëshmi të Aftësisë Profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR. **minimalisht** si më poshtë:

- Manovratore 3 (tre)
Shofer 4 (katër)

Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Kontratat e punës të vlefshme;
- Dokument (dëshmi kualifikimi profesional), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

** Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si me sipër, emer/mbiemer, numrin dhe datën e dëshmisë së aftësisë profesionale.*

****(Në rastet kur mjetet/makineritë disponohen me qera, këta punonjës mund të jenë të kontraktuar).***

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi : *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.*

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

e. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të disponojë 32 punetore të thjeshtë ndërtimi, për te cilët te paraqitet kontratat e punës si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimalisht për muajin e fundit kur jan pjes e stafit të shoqërisë ose kur janë siguruar nga operatori ekonomik me anë të marrëdhënies kontraktore për ekzekutimin e kontratës objekt prokurimi nuk kërkohet të figuroj në listëpagesat përkatëse.

Ne rastin e bashkimit te operatoreve ekonomik, cdo anetar i grupit duhet te paraqese punojesit e mesiperm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë llogaritur nepermjet analizave teknike nga antaret e NJ.P me profil inxhinier ndertimi, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht Vendimit Nr. 216 Datë 13.04.2023 "PËR KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË INTEGRUAR PËRINFORMATIZIMIN E MANUALIT TË ÇMIMEVE PËR ZËRAT E PUNIMEVE NË NDËRTIM".Numri I punëtorëve është si rezultat I anlizës teknike që kanë antarët e NJ.P me

profil inxhinier ndertimi, bashklidhur rocesverbalit në dosje kopje e analizë së llogaritjes teknike për nr e punëtorëve, mjeteve, makinerive sp.te ndertimit etj.

2.3.4. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtoje prej minimalisht **38(tridhjetë e tetë) persona te pasqyruar në listëpagesën e muajit e fundit.** Për përmbushjen e këtij kushti operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet Shoqërore ose Administrata Tatimore sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin e fundit.
- Listëpagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për muajin e fundit.

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kjo pik. duhet të plotësohet nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar me ligjin nr.16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Per prokurimin publik" në të cilin thuhet: "Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".

Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve, tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtoje të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiqet të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosja e kriterit për një punësim të paktën 38 është në përputhje me volumin e punës, natyrën, ku do të kryhen punimet. Po t'i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale,

personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

2.3.5. Numri dhe lloji i makinerive,paisjeve ne pronesi/qira: Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës mbi 20 ton	në pronësi ose me qira	Cope 5
Kamioncine me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Cope 2
Eskavator me goma	në pronësi ose me qira	Cope 1
Grejder	në pronësi ose me qira	Cope 1
Rrul	në pronësi ose me qira	Cope 1
Betoniere	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vibrator	në pronësi ose me qira	Copë 1
Vinc	në pronësi ose me qira	Cope 1
Trapano	në pronësi ose me qira	Cope 1
Spërkatës	në pronësi ose me qira	Cope 1
Elektrosaldatriçe	në pronësi ose me qira	Cope 1
Gazogjen	në pronësi ose me qira	Cope 1

- a) *Për mjetet me rrota që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- b) *Për mjetet e siguruara me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit te vlefshme), duhet te shoqerohet me*

kontraten perkatese te qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e zhdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.

- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, si kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese.*
- d) Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.*
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit dhe Makineritë e mësipërme nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera apo të deklaruara ne procedura te shpallura fitues.*

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike pikat e kriterit 2.3.5. duhet te plotesohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi : *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Mjetet dhe pajisjet e kërkuara janë vendosur në proporcion me zërat dhe volumet e punimeve dhe afatin e përllogaritur për realizimin e kontratës objekt prokurimi.*

Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronesi / qira janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke i'u referuar punimeve sipas standardeve, grafikut, kohëzgjatjes së punimeve dhe specifikimeve teknike të projekt zbatimit. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomikë duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin ofertuesit. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisjet dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë. Për këtë duhet të paraqesin certifikatën e mëposhtme:

- **Çertifikatë ISO 9001:2015 ose ekuivalente** mbi **“Sistemet e menaxhimit të cilësisë”** lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;

(Në rastin e bashkimit të operatoreve ekonomike kjo pik. duhet të plotësohen nga secili anëtar i bashkimit, në përputhje me natyrën e punimeve dhe përqindjen e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në akt marrëveshje).

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” indryshuar, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikata e kërkuara janë në përputhje me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve. ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **2(dy)** muaj kalendarike.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 3. **Ky kriter vendoset me qëllim që të përcaktohet në mënyrë të qartë shpërndarja e fuqisë puntore dhe e mjeteve me anë të një grafiku punimesh.**

2.3.8 Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neni ku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26, pika 1e VKM-së, nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Punimet objekt prokurimi, të cilat shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, bazohen në parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 16/2024 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

Specifikimet teknike të këtij objekti prokurimi janë përcaktuar nga projektuesi, sipas materialit bashkëlidhur ne SPE.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor, **nr.96, datë.29.07.2024**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: "**Ndërtim i parkut të ri të qytetit**", me fond limit prej: **25 770 830 (njëzetë e pesë milion e shtatëqindë e shtatëdhjetë mijë e tetëqindë e tridhjetë) lekë pa tvsh., lloji i procedurës: E hapur.**

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës .

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP dhe VKM nr.285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

Argumentim Sp.teknike:Anëtarët pranuan dokumentacionin teknike të hartuara dhe mar në dorëzim të dokumentacionit teknik të Shoqëria“Novatech Studio” sh.p.k nga Komisioni i posaçëm :KLLFLST(Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike) i ngritur me urdhër të titullarit të Autoritetit Kontrakt nr.5729prot,datë 25.07.2024,duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për pajisjen(F.V) që do të blejë.Preventivi është hartuar hartuara nga Shoqëria“Novatech Studio” sh.p.k,dorëzuar dokumentacioni teknik me procesverbalin e komisionit nr.5729/1prot,datë25.07.2024dhe shprehin qarte kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e punimeve.

**Preventivi I hartuara nga Shoqëria“Novatech Studio” sh.p.k si mëposhtë për objektin:
"Ndërtim i parkut të ri të qytetit"**

PREVENTIVI PERMBLEDHES

Objekti:"Ndërtim i parkut të ri të qytetit"

Nr.	Analize	Pershkrimi i Punimeve	Njesia	Sasia
	A	PUNIME PER PARKUN		
	I	Punime ndertimi		
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	2970
2	3.45/1	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	m3	68
3	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m ³	3038
4	3.183/c	Shtrese zhavor lumi t=20cm	m2	2,889
5	An.1	F.V. Pllaka betoni 6cm veteshtrenguese	m2	2,410
6	3.239	N/shtr. bet. 10cm niv.e fiks.e bord C 7/10	m ³	29
7	1.126/p	F V bordura betoni 15x35 cm	ml	834

8	3.619/a	Bordura betoni 6x20 cm per peme	ml	352
9	3.182/b	Ishuj shtrese rere t=15 cm	m2	480
10	3.243	Struktura b/a c 16/20 per stola tip 3	m3	22
11	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.3
12	2.167	F V hekur betoni periodik > 10 mm	ton	0.4
		Shuma I		
	II	Punime per shatrivanin		
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	87
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m ³	87
3	3.183/c	Shtrese zhavor lumi t=20cm	m2	162
4	An.2	Shtrese pllaka terakote	m2	108
5	3.243	Struktura monolite betoni C 16/20	m3	43.2
6	3.243	Struktura b/a c 16/20 per stol rreth shatrivanit	m3	64.5
7	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.6
8	2.167	F V hekur betoni periodik > 10 mm	ton	0.8
9	An.3	Listela per stolat	m2	24
		Shuma II		
	III	Punime per amfiteatrin		
1	3.243	Struktura b/a c 16/20 per stol amfiteatri	m3	110
2	2.166	F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm	ton	0.9
3	2.167	F V hekur betoni periodik > 10 mm	ton	1.1
4	An.3	Listela per stolat	m2	52
		Shuma III		
	IV	Punime gjelberimi		
1	An.4	Sistemim, nivelim dhe pasurim dheu me humus 5kg/m2	m2	1489
2	An.5	Mbjellje siperfaqe me bar	m2	1489
4	3.961	F.V. Fidane Peme dekorative	cope	25
		Shuma IV		
	V	SISTEMI UJITJES		

sistemi I ujitjes se parkut				
1	An.6	F.V. pompe 1.1kw Qmax=140l/min Hmax= 22m		1
2	2.491/2e	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, t = 3.7 mm, PN 10	ml	480
3	2.491/2d	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=40mm, t = 3.0 mm, PN 10	ml	20
4	3.390	F V tuba plastmase per vaditje, Ø 25 mm	ml	1320
5	2.494/4	F.V saracineska bronzi Ø 1 1/2 " = 40 mm	cope	15
6	2.494/1	F.V saracineska bronzi Ø 3/4 " = 20 mm	cope	40
7	3.45/1	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	m3	90
8	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	60
9	2.488	F V rezervuari zingato 5000 litra	cope	2
sistemi I ujitjes se shatervanit				
1	2.491/2f	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=63mm, t = 4.7 mm, PN 10	ml	200
2	An.6	F.V pompe 1.1kw Qmax=140l/min Hmax= 22m	cope	2
3	2.576/2	Puse kontrolli 1.5x1.5x1,5m	cope	1
4	An .7	F.V Saraçineske PPR 1/2"	cope	3
5	3.45/1	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²		40
6	2.258	Nenshtrese zhavori	m3	30
7	2.488	F V rezervuari zingato 5000 litra	cope	2
8	2.233	Shpim pusi 20 m komplet +aksesore	cope	1
Shuma V				
VI PUNIME PER MOBILIM URBAN				
1	An.8	F.V.Rreshkitese per femije (kabine + shkalle + plan rreshkites)	cope	2
2	An.9	F.V. Kolovajse per femije (bazament ulje + bazamet mbajtes)	cope	1
3	An.10	F.V.kosha		15

		Shuma VI		
		SHUMA A		
	B	PUNIME PER FUSHEN E SPORTIT		
		1.Punime shtresa		
1	3.89/a	Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m ³ , ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet	m3	304.6
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	304.6
3	3.205/2	Shtrese zhavori t=20cm, perhapur e ngjeshur me makineri	m2	522
4	2.262/4	Shtrese betoni C-16/20 t=15 cm	m3	78.3
5	2.166	F.V. hekur betoni periodik Φ 6 - 10 mm	ton	3.3
6	An.11	Shtrese gome 1.2 cm + praimer	m2	522
7	An.12	Shtrese taratan	m2	522
8	3.949/1	Vizime me boje bikomponente me gjeresi 15 cm	ml	170
		Shuma 1		
		2. Punime rrethimi		
1	3.45/1	Germim kanalesh ne toke te zakonshme, me krahe, me seksion deri 0.75 m ²	m3	32.0
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	32.0
3	2.262/4	Beton per themelin dhe xokol C-16/20	m3	16.7
4	2.258	Nenshtrese zhavori nen themel	m3	3.2
5	An.13	Rrethim I fushes me rrrjete metalike(H=2m)	m2	180
6	An.14	Rrethim I fushes me rrrjete plastike (H=3m)	m3	270
7	2.182	Koloncina metalike dhe porta	ton	6.3
8	2.401	Lyerje konstruksione metalike	m2	180
		Shuma 2		
		Shuma B		
	C	PUNIME ELEKTRIKE		
1	3.89/a	Germim dheu kanal kablo, shtyllat dhe pusetat + transp. mat . 5 km	m3	70
2	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	70
3	2.261/a	Nenshtrese rere	m3	11
4	2.496	FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm, L=150cm	cope	33

5	3.17	F V pusete elektrike kontrolli PVC 40x40x40cm	cope	33
6	An.15	FV pusete BA 60x60x60, kapak gize	cope	2
7	An.16	F.V. Kuader komandimi per ndricimin rrugor me fotoelemet	cope	1
8	An.17	F.V.Kabell Cu me dy shtresa mbrojtese 5x6mm ²	ml	200
9	An.18	F.V.Kabell Cu me dy shtresa mbrojtese 5x4mm ²	ml	50
10	An.19	F.V.Kabell Cu me dy shtresa mbrojtese 5x2,5mm ²	ml	54
11	An.20	F.V.Kabell Cu me dy shtresa mbrojtese 3x2,5mm ²	ml	180
12	An.21	F.V.Percjelles Cu 16mm ² I veshur GV	ml	33
13	An.22	F.V. Tub fleksibel me 2 shtresa D=63mm	ml	301
14	3.24	F.V Beton C 12/15 per fiksimin e shtyllave	m ³	6
15	An.23	F.V. Tuba metalik D=110mm	ml	7
16	An.24	F.V.Shtylle klasike ndricimi H=4,3m, me dy krahe 2x40W/LED	cope	33
17	An.25	Shirit tregues per trase kablli	ml	306
		Shuma C		
		SHUMA A-C		
		Fond rezerve 2%		
		SHUMA		
		T.V.SH. 20%		
		VLERA TOTALE		

Dokumentacioni pasi u firmos nga të 5(pesë) anëtarët e Njesisë së Prokurimit , pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: